



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.304/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Subjekti Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 04.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohen të pabazuara ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.304/2025, Anr.313/2025, Anr.318/2025, Anr.322/2025 të datës 02.02.2025 paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025

A r s y e t i m

Me datë 02.02.2025 PZAP ka pranuar ankesat e identifikuara Anr.304/2025, Anr.313/2025, Anr.218/2025, Anr.322/2025 të parashtruara nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë.

Në ankesën Anr.304/2025 pretendohet se me 02.02.2025, Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë gjatë monitorimit të fushatës politike ka vërejtur gjuhë denigruese dhe fyese nga kandidati për deputet z.Lumir Abdixhiku, në tubimin në Suharekë, me datë 01.02.2025 të LDK-së me çka ndër të tjera thotë: *Partitë Politike po e kopjojnë programin tonë.*

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur CD nga tubimi.

Në ankesën Anr.313/2025 pretendohet se me datë 02.02.2025 Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë gjatë monitorimit të fushatës politike ka vërejtur gjuhë denigruese dhe fyese nga kandidati për deputet z.Avdullah Hoti, në postimin e tij në rrjetin social

facebook, me datë 31.01.2025 të LDK-së me çka ndër të tjera thotë: “Etiketimi, nënçmimi dhe sulmet që i ka bërë kjo qeveri ndaj komunitetit të biznesit do të marr fund me 09 shkurt.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur CD nga tubimi.

Në ankesën Anr.318/2025 pretendohet se Më 02 shkurt 2025, aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Prishtinë, gjatë monitorimit t-ë fushatës zgjedhore kanë vërejtur asambleistin e LDK-së, z. Sami Salihu duke përdorur gjuhë fyese dhe denigruese ndaj VV, ku shprehimisht thotë "*Ja si e mbrojnë Veriun e Mitrovicës, Qeveria*".

Në ankesën Anr.322/2025 pretendohet se Më 02 shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Prishtinë, gjatë monitorimit të tubimeve politike ka vërejtur gjuhë denigruese dhe fyese nga kandidati për deputet z. Lumir Abdixhiku, në tubimin e mbajtur në qytetin e Suharekës, me datë 01.02.2025 të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), me çka mandatin e fundit qeverisës e quan "*sulmues të kundërshtarëve politik sulmues të mediave sulmues të aleatëve* (fjala për shtetet aleate të Kosovës).

Si provë parashtruesi I ankesës ka bashkangjitur CD nga fjalimi.

Më këto veprime subjekti politik LDK ka bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11, të LPZ-së.

PZAP me datë 03.02.2025 iu është drejtuar me kërkesë për përgjigje subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), deri më datë 03.02.2025 në ora 19:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 03.02.2024 subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës ka theksuar se shprehja "*partitë politike po e kopjojnë planin tonë*" shprehja "*Etiketimi, nënçmimi dhe sulmet që i ka bërë kjo qeveri ndaj komunitetit të biznesit do të marr fund me 09 shkurt*" shprehja "*Ja si e mbrojnë Veriun e Mitrovicës, Qeveria*" dhe shprehja "*sulmues të kundërshtarëve politik, sulmues të mediave, sulmues të aleatëve*". nuk kanë lidhja me nxitje të urrejtjes ndaj askujt, kujdo apo diçkaje dhe se përdorimi i fjalëve të tilla është një pjesë e normave të diskursit politik dhe është i nevojshëm për te vlerësuar dhe analizuar qëndrimet e kundërshtarëve politik në mënyre të drejtë dhe pa qëllime fyese.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si ne vijim: Anr.304/2025, Anr.313/2025, Anr.318/2025, Anr.322/2025 të datës 02.02.2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.304/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti i njëjtë politik LVV kundër subjektit të njëjtë politik LDK, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

PZAP, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZZP-së, vëren se:

Ankesat janë të pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik LDK, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet: “Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: *përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë*”.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik LDK, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që parashtruesi i ankesës, në ankesë e ka bashkangjitur CD e personave në fjalë, mirëpo shprehja “*partitë politike po e kopjojnë planin tonë*” shprehja “*Etiketimi, nënçmimi dhe sulmet që i ka bërë kjo qeveri ndaj komunitetit të biznesit do të marr fund me 09 shkurt*” shprehja “*Ja si e mbrojnë Veriun e Mitrovicës, Qeveria*” dhe shprehja “*sulmues të kundërshtarve politik, sulmues të mediav, sulmues të aleatve*”, sipas vlerësimit të Panelit janë në përputhje me diskursin e zakonshëm që perdoret gjatë fushatës zgjedhore dhe i njëjti nuk ka karakter fytes, denigrues apo nxitës të urrejtjes ndaj subjektit politik Vetëvendosje apo të Qeverisë së Kosovës dhe nuk përbën shkelje të rregullave zgjedhore.

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që nga provat e ofruara si dëshmi të cilat parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur ankesës, nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “*vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
A.nr.304/2025, datë 04.02.2025

Kryesues i Panelit
Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.